



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 582/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.09.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e shoqërisë “BNT Electronics” sh.p.k në procedurën e prokurimit me Nr. Ref-59090-03-28-2018, me objekt: “Blerje pajisje kompjuterike për nevoja të shoqërisë”, me fond limit 9.199.361 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.04.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujesjelles-Kanalizime Tiranë sh.a.

Ankimues:

“BNT Electronics” sh.p.k
BLV “Zhan D’Ark”, Kulla 3, Kati II, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Ujesjelles-Kanalizime Tiranë sh.a
Rruga “5 Maj”, pranë Medresesë Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I


Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.



II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 18.05.2018 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr. Ref-59090-03-28-2018, me objekt: “Blerje pajisje kompjuterike për nevoja të shoqërisë”, me fond limit 9.199.361 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.04.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujesjelles-Kanalizime Tiranë sh.a.

II.2. Në datën 24.05.2018 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht për klasifikimin përfundimtar të ofertave dhe ofertuesit e skualifikuar si më poshtë:

1. “Advanced Bussiness Solution (ABS)” sh.p.k	4.870.000 lekë, skualifikuar
2. “BNT Electronics” sh.p.k	5.960.620 lekë, skualifikuar
3. “PC Store” sh.p.k	6.989.560 lekë, kualifikuar
4. “CCS” sh.p.k	6.900.030 lekë, kualifikuar
5. “Divitech ” sh.p.k	7.890.000 lekë, kualifikuar
6. “ISEC” sh.p.k	7.994.410 lekë, kualifikuar

Operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k rezulton i skualifikuar pasi:

“Gjatë shqyrtimit të ofertave për procedurën me objekt” Blerje Pajisje Elektronike për Nevoja të Shoqërisë”, u konstatua se oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” konkretisht në vlerën 5.960.620 (pesë milion e nëntëqind e gjashtëdhjetë mijë e gjashtëqind e njëzetë) lekë pa tvsh është anomalisht e ulët. Në këto kushte, në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku shprehimisht thuhet se 1) Kur AK verën se një ose me shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementet e veçantë të ofertës për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit apo shërbimeve të ofruara b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve të propozuara nga ofertuesi d) zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës në vendin ku do të kryhet apo ku do të sigurohet furnizimi.... Në zbatim të dispozitave të mësipërme Komisioni i Vlerësimit të Ofertave më datë 15.05.2018 iu drejtua operatorit ekonomik “BNT ELECTRONICS” me anë të kërkesës për sqarim oferte anomalisht të ulët. Më datë 18.05.2018 nëpërmjet mesazheve elektronike u konstatua se operatori ekonomik BNT ELECTRONICS ka bashkëngjitur shkresën me lëndë “ Sqarim mbi Ofertën Anomalisht të Ulët”. Së pari Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se operatori ekonomik nuk ka respektuar formën në të cilën e kërkon ligji përkatësisht neni 56 pika 1 në të cilën parashikohet se.... Kur AK verën se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elementet e veçantë të ofertës Megjithatë edhe nëse pranohet forma e shkresës e paraqitur në sistemin elektronik, K.V.O konstaton se në argumentimin dërguar UKT sh.a, operatori ekonomik sqaron se ... “Duke qënë se institucioni juaj ka një rol të rëndësishëm dhe procedura e prokurimit të zhvilluar nga ju është e një rëndësie të veçantë, shoqëria jonë i ka kërkuar partnerëve tanë suport specifikisht për këtë procedurë dhe për këtë arsye oferta jonë është specifikisht për këtë procedurë dhe për këtë arsye oferta jonë është konform specifikimeve teknike të kërkuara nga AK dhe me çmimet konkurruese”. Referuar argumentimit të operatorit ekonomik, në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se 1. Kur autoriteti kontraktor verën se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku

do të sigurohet furnizimi. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. Në interpretim të nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.V.O gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për për furnizimin e mallrave. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Gjithashtu K.V.O thekson se katër kushtet të parashikuara në neni 56 pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistemin elektronik nga operatori ekonomik “BNT ELECTRONICS” sh.p.k rezulton se ky i fundit nuk është konform kërkesave të përcaktuara në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstaton se ankimuesi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës ose provues si: fatura tatimore, fletë zhdoganimi, kontrata furnizimi, kontrata të mëparshme të lidhura me autoritete të ndryshme, apo ndonjë dokument tjetër, që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Operatori ekonomik ankimues ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues që do të garantonin realizimin e furnizimit të mallrave

pranë autoritetit kontraktor. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se nga ana e operatorit ekonomik BNT ELECTRONICS – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj. Sqarojmë se risku që mund të shfaqet nga një ofertë anomalisht të ulët është në disa drejtime nga të cilat përmendim rrezikun për mos kryerjen e furnizimit në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e furnizimit brenda afateve kohore të parashikuara, humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme. Rrjedhimisht Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se nga ana e operatorit ekonomik nuk është sjellë argumentimi i ofertës anomalisht të ulët në respekt të nenit 56 të LPP-së, ndaj dokumentacioni i paraqitur nga ky operator nuk konsiderohet i vlefshëm. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, nenit 56 pika 2 i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi pas shqyrtimit të shpjegimit të ofertës anomalisht të ulët nuk bindet se është e rregullt në të gjitha elementët e saj..”

II.3. Në datën 24.05.2018 operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar skualifikimin e tij në procedurën e prokurimit. Konkretisht pretendohet:

“[...]

Së pari, LPP, neni 3 “Përkufizimet”, pika 22, parashikon “Komunikimi me shkrim” është cdo shprehje që përbëhet nga fjalë ose shifra, të cilat mund të lexohen, kopjohen dhe komunikohen,

përfshirë edhe informacionet që transmetohen ose ruhen në mënyrë elektronike. Referuar kësaj dispozite, pretendimi juaj nuk qëndron përse i përket përgjigjes me shkrim nga operatori ynë ekonomik. Përgjigja e kthyer nga shoqëria jonë është konform rregullave ligjore, me shkrim dhe nëpërmjet portalit elektronik të APP-së.

Së dyti, përse i përket thelbit të sqarimit të ofertës tonë anomalisht të ulët, shkresa e ngarkuar në sistemin e APP-së përmban informacionin e duhur për të sqaruar origjinën e cmimit të ulët. Në këtë shkresë ju kemi bërë të ditur se shoqëria jonë, duke patur në konsideratë rëndësinë e institucionit tuaj, kemi kërkuar cmime tejet favorizuese nga prodhuesi i pajisjeve me të cilin kemi marrëdhënie partneriteti që prej më shumë se 20 vite.

Sqarimi ynë është konform LPP, neni 56.

Gjithashtu institucioni juaj në të njëjtën kohë me sqarimin e ofertës, duhet të vlerësojë ofertën në tërësi, duke përfshirë edhe kriteret e kualifikimit të cilat plotësohen plotësisht nga shoqëria jonë. Në këtë procedurë prokurimi ne kemi paraqitur autorizim nga prodhuesi që është një garanci shumë e fortë për realizimin e kontratës e cila provon marrëdhënien e distribucionit, garancinë që pajisjet janë origjinale dhe nga një prodhues i njohur ndërkombëtarisht. Përveç kësaj ne kemi paraqitur edhe furnizime të ngjashme të realizuara me institucione të tjera të cilat edhe këto janë një garanci tjetër për realizimin e kontratës. Në këto kontrata gjenden vlera përkatëse për pajisjet. Pra përse më lart, institucioni juaj duhet të vlerësojë objektivisht ofertën ekonomike duke marrë parasysh edhe dokumentacionin e kërkuar në kriteret kualifikuese specifikuara “Kontratat e ngjashme”, të realizuara nga operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k gjatë aktivitetit të tij për periudhën e fundit të kërkuar, me anë të të cilave dëshmohet se ky i fundit zotëron kapacitete për realizimin me sukses të kontratës, kjo në funksion të mirëmenaxhimit të fondeve publike dhe shmangien e përzgjedhjes së ofertave me cmim jo konkurrues. Sa më lart, në respekt të parimit të mirëmenaxhimit të fondeve publike, përkatësisht nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore, të sigurojë mirëpërdorimin e fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale”, gjykojmë se autoriteti kontraktor duhej të kualifikonte ofertën e paraqitur nga shoqëria jonë.

Bazuar në LPP, autoriteti kontraktor ka në dispozicion mjete të tjera për të siguruar realizimin e kontratës. Neni 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP-së përcakton: “1. Autoriteti kontraktor përcakton në dokumentat e tenderit organin ose organet, nga të cilët kandidati ose ofertuesi mund të marrë informacionin e duhur për detyrimet fiskale, për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e punonjësve dhe kushtet e punës që janë në fuqi në Shqipëri ose në rajonin apo njësinë vendore ku do të zbatohet kontrata. 2. Ofertuesit ose kandidatit mund t’i kërkohej të dëshmojë se gjatë hartimit të ofertës i ka marrë parasysh detyrimet që shoqërojnë zbatimin e kontratës, sic është vendosur nga organet kompetente, në përputhje me pikën 1 të këtij neni. 3. Detyrimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe kushtet e parashikuara në nenin 46 të këtij ligji, janë të vlefshme gjatë të gjithë periudhës së zbatimit të kontratës. Cdo shmangie nga këto kushte apo detyrime, con në

prishjen e kontratës. Autoritetet kontraktore janë përgjegjëse për përdorimin e fondeve publike sipas rregullave ligjore për prokurimin.

Duke qënë se, sic përmendëm edhe më lart, institucioni juaj ka patur në dispozicion mjete dhe dokumentacion të mjaftueshëm të paraqitur në tender, të cilat garantojnë realizimin e kontratës si dhe duke patur në dispozicion edhe deklaratën tonë ku konfirmojmë se kemi marrë cmime speciale nga prodhuesi enkas për këtë procedurë, gjejkojmë se skualifikimi i shoqërisë sonë është në kundërshtim me frymën e legjislacionit të prokurimit publik.

Përsa më lart kërkojmë shfuqizimin e vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga BNT Electronics si dhe kualifikimin e kësaj oferte e cila plotëson të gjitha kriteret ligjore dhe teknike me cmim shume të ulët.”

II.4. Nëpërmjet shkresës nr. 14240/1 prot., datë 25.05.2018 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimesit si më poshtë:

“[...] KSHA pasi mori në shqyrtim ankesën e operatorit ekonomik, procesverbalet e vlerësimit si dhe shkresën e dërguar nga operatori ekonomik me lëndë: “Dërgim informacioni për ofertën anomalisht të ulët”, gjykon se operatori ekonomik nuk ka argumentuar cmimin e ofertës anomalisht të ulët sipas formës së kërkuar nga ligji. Gjithashtu gjatë shqyrtimit të dokumentacionit konstaton se ankimesi nuk ka bërë analizë të cmimit për zërat e preventivit por e ka konsideruar të mjaftueshëm dhënien e një deklarate se do të suportohet nga partnerët e saj për realizimin e kontratës, cka bie në kundërshtim me nenin 56 të LPP-së si dhe nenin 66 të rregullave të prokurimit publik. [...] Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se barra e provës mbi argumentimin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik oferta e të cilit është konstatuar nga KVO-ja dhe në zbatim të VKM-së 914/2014, i ndryshuar. Gjithashtu KSHA gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushtet kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimes duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të vecanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi si dhe së fundi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

KSHA gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat me anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse, duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimes, ofertat e të cilëve rezultojnë anomalisht të ulët. Nga shqyrtimi i argumentimeve të dhëna nga operatori ekonomik KSHA konstaton se operatori ekonomik nuk ka plotësuar asnjë prej kushteve të parashikuara në nenin 56, pika 1 të LPP-së. KSHA gjykon se qëllimi i nenit 56, pika 1 e LPP-së lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riskut që mund të sjellë një ofertë e cila rezultojnë anomalisht të ulët. [...]

Referuar pretendimit se AK duhet të merrte parasysh dokumentacionin e kërkuar në kriteret kualifikuese për të cilat janë paraqitur në sistemin elektronik nga operatori ekonomik sqarojmë se nuk jeni skualifikuar nga ana e KVO-së me arsyetimin se nuk keni përmbushur kriteret e kualifikimit të DST-ve, por se nuk keni arritur që nëpërmjet argumentimit tuaj dhe dokumenatcionit të paraqitur nga ana juaj ti krijoni bindjen AK-së se do të realizoni kontratën me sukses në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP-së.

Me anë të dokumentacionit të paraqitur ankimesi nuk ka mundur për fajin e tij të krijojë bindjen tek autoriteti kontartor lidhur me këtë fakt, e në këtë kuptim KSHA gjykon se skualifikimi i tij nga kjo procedurë prokurimi është i drejtë dhe konform rregullave të prokurimit publik.”

II.5. Në datën 04.06.2018 operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar si vijon:

“[...] Përsa i përket pretendimit të institucionit lidhur me formën ligjore të parashikuar për mënyrën e sqarimit të ofertës anomalisht të ulët ju sqarojmë se vetë UKT i është drejtuar BNT Electronics me kërkesën për sqarimin e ofertës në mënyrë shkresore nëpërmjet sistemit të APP-së dhe nuk ka paraqitur asnjë shkresë në hardcopy pranë zyrave tona. Shoqëria jonë i ka kthyer përgjigje UKT-së në të njëjtën rrugë që ka ndjekur vetë AK, pra keni dërguar sqarimin tonë në formë shkresore nëpërmjet sistemit të APP-së [...].

Së dyti përsa i përket thelbit të sqarimit të ofertës sonë anomalisht të ulët, shkresa e ngarkuar në sistemin e APP-së përmban informacionin e duhur për të sqaruar origjinën e cmimit të ulët. Nëpërmjet kësaj shkrese kemi bërë me dije AK-në se, duke patur në konsideratë rëndësinë e vecantë të këtij institucioni, kemi kërkuar cmime tejet favorizuese nga prodhuesi i pajisjeve me të cilin kemi marrëdhënie partneriteti që prej më shumë se 20 vite.

Në rastin konkret neve nuk kishim si të bënim një analizë për procesin e prodhimit të mallrave, anën ekonomike të metodës së ndërtimit etj sic parashikon LPP-ja pasi vetë prodhuesi i pajisjeve që merret me këtë çështje ka arritur të japi një cmim tejet favorizues për këtë institucion dhe mbi të gjitha duke ofertuar pajisje të cilat janë në përputhje me të gjitha kërkesat teknike të vetë UKT-së. BNT Electronics sh.p.k është distributore e firmës prodhuese Fujitsu dhe Kyocerasi e autorizuar drejtpërdrejtë nga Bentley dhe është normale që të kemi cmime të preferueshme si për pajisjet ashtu edhe për licencat. Kjo është arsyeja dhe origjina e cmimeve tona të ulta ndryshe nga shoqëria fituese e cila rezulton të jetë me cmime më të larta pasi është një firmë që nuk është distributor i pajisjeve kryesore. Kontrata për të cilën ne jemi skualifikuar nga AK është një kontratë furnizimi pra nuk është një kontratë shërbimi në të cilin përfshihen shumë elementë përbërës të cilët nuk mund të vlerësohen që në momentin e lidhjes së kontratës, sic mund të jetë në kontratat me objekt punime rrugësh, ujesjellës-kanalizimesh etj. Në këtë rast institucioni përfitues mund të ndihet i rriskuar nga mospërmbushja e detyrimeve kontraktuale dhe është me vlerë llogaritja e ofertës me vlerë anomalisht të ulët, pasi operatori ekonomik mund tia ketë futur kot.

Në rastin konkret firma jonë BNT Electronics, distributore e autorizuar për produktet Fujitsu dhe Kyocera, si dhe duke qënë një nga firmat më të njohura në fushën e prodhimit dhe furnizimeve me software, ka marrë një cmim special nga BENTLEY për upgrade të licencave të Watercad.

Sigurisht që një firmë që nuk është distributore e firmave prodhuese dhe që nuk merret me programim nuk mund të marrë cmim konkurrues me cmimin tonë [...]”.

II.6. Në datën 13.06.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1056/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. K-2560/1 prot., datë 12.06.2018, bashkëngjitur informacioni e dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

II.7. Në datën 08.08.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1056/4 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Nr.K-2560/3 Prot., datë 07.08.2018, në përgjigje të kërkesës për informacion të KPP-së, bashkëngjitur dokumentacioni mbi argumentimin e ofertës ekonomike të shoqërisë “BNT Electronics” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k se: “[...] nga ana e operatorit ekonomik BNT ELECTRONICS – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka dalë anomalisht e ulët, janë paraqitur sqarime dhe dokumentacion jo i plotë që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet shkresës nr. 9958/4 prot., datë 15.05.2018 me objekt: “Kërkesë për sqarim oferte anomalisht të ulët”, drejtuar operatorit ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k, autoriteti kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik si vijon:

“Gjatë shqyrtimit të ofertave nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për objektin “Blerje pajisje elektronike për nevojat e shoqërisë”, u vërejt se oferta e paraqitur nga ana juaj me vlerë 5.960.620 lekë pa tvsh është anomalisht e ulët. Në zbatim të nenit 56 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, shprehimisht thuhet: “1)Kur AK verën se një ose me shumë oferta për kontratat e mallrave, puneve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 diteve pune shpjegime për elementet e vecante të ofertes për: a)anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit apo shërbimeve të ofruara b)zgjidhjet teknike të ofruara dhe ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për kryerjen

e punimeve, per furnizimin e mallrave apo te sherbimeve c) origjinalitetin e puneve, mallrave apo te sherbimeve te propozuara nga ofertuesi d) zbatueshmerine e detyrimeve qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes ne vendin ku do te kryhet apo ku do te sigurohet furnizimi.” Në këto kushte, në zbatim të përcaktimit të dispozitave të mësipërme, duhet të paraqisni me shkrim, brenda afatit 3 ditor, argumentimin e cmimit të ofertës të dhënë, shoqëruar me dokumentacionin provues. Për cdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në një nga format e parashikuara në rregullat e prokurimit publik. Mosrespektimi i kërkesës së mësipërme nga ana juaj, përbën kusht për skualifikim.”

III.1.2. Në datën 18.05.2018, nëpërmjet mesazheve elektronike (shkresë e dërguar autoritetit kontraktor nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike) operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k ka bashkëngjitur shkresën me datë 16.05.2018 dhe objekt: “Dërgim informacioni për ofertën anomalisht të ulët, paraqitur për procedurën me objekt: “Blerje pajisje elektronike për nevoja të shoqërisë””, me këtë përmbajtje.

“Në përgjigje të kërkesës suaj të publikuar në sistemin e APP-së në datë 15.05.2018 në lidhje me ofertën anomalisht të ulët, ju dërgojmë sqarimet tona si më poshtë:

Duke qënë se institucioni juaj ka rol të rëndësishëm dhe procedura e prokurimit të zhvilluar nga ju është e një rëndësie të vecantë, shoqëria jonë i ka kërkuar partnerëve tanë suport specifikisht për këtë procedurë dhe për këtë arsye oferta jonë është konform specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe me cmimet më konkurruese.”

III.1.3. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se: “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.1.4. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak

oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.1.5. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar e tillë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik ankimues duhet të dorëzojë, në mënyrë të detajuar, anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomik, oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët, të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga LPP, janë kushte kumulative të cilat, me anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse, duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimues, oferta e të cilëve rezulton anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të infomacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi i normës së mësipërme lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë, e cila rezulton anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezulton anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për mos kryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga mos kryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ri publikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit ekonomik oferta e të cilit rezulton anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë

mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijnë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlogaritjes të parashikuar në ligj.

III.1.6. Nisur nga sa më sipër cituar, Komisioni i Prokurimit Publik verifikoi ofertën ekonomike të operatorit ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k dhe nga ky verifikim rezulton se, nga ana e këtij operatori është paraqitur oferta ekonomike, plotësuar sipas zërave të kërkuara nga autoriteti kontraktor. Nga llogaritjet e kryera nga Komisioni i Prokurimit Publik, referuar bazës ligjore si më sipër, rezulton se oferta e operatorit ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k është anomalisht e ulët dhe, sipas informacionit të autoritetit kontraktor, rezulton se edhe Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e ka konstatuar këtë fakt, dhe me anë të shkresës nr. 9958/4 prot., datë 15.05.2018, ka kërkuar nga operatorit ekonomik të paraqiste me shkrim, brenda afatit 3 ditor, argumentimin e cmimit të ofertës të dhënë, shoqëruar me dokumentacionin provues.

III.1.7. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe ankimuesi rezulton se, nga ana e operatorit ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k., me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët i është dërguar elektronikisht AK-së shkresa me datë 16.05.2018 me sqarimet si vijon: *“Duke qënë se institucioni juaj ka rol të rëndësishëm dhe procedura e prokurimit të zhvilluar nga ju është e një rëndësie të vecantë, shoqëria jonë i ka kërkuar partnerëve tanë suport specifikisht për këtë procedurë dhe për këtë arsye oferta jonë është konform specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor dhe me cmimet më konkurruese.”*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi analizoi informacionin e ankimuesit “BNT Electronics” sh.p.k, në mbështetje të ofertës së paraqitur në procedurën e mësipërme të prokurimit, vëren se ky i fundit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion mbështetës ose provues si: fatura tatimore, kontrata furnizimi, marrëveshje apo ndonjë dokument tjetër, që të argumentojë kushtet apo elementët e favorshëm pse kjo ofertë e dalë anomalisht e ulët duhet të pranohet dhe se nuk krijon asnjë rrezik për mosrealizimin me sukses të kontratës. Akoma edhe më tej, ankimuesi pohon se ka marrë cmime speciale nga prodhuesi enkas për këtë procedurë, por nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion nga prodhuesi që të provojë këtë fakt.

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se shoqëria “BNT Electronics” sh.p.k, nuk ka paraqitur prova shkresore për elementet e ofertës as në autoritetin kontraktor dhe as në KPP. Operatori ekonomik ankimues ka detyrimin ligjor që të prezantojë me dokumentacion provues zgjidhjet teknike dhe/ose ndonjë kusht favorizues që do të garantonin realizimin e punimeve pranë autoritetit kontraktor. Paraqitja e shkresës së mësipërme, e pashoqëruar me dokumentacionin shtesë provues nuk mund të konsiderohet si provë pasi në vetvete nuk provon dhe garanton ofertën ekonomike si dhe realizimin e kontratës.

Bazuar në arsyetimin dhe faktet e shtjelluara më lart, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nga ana e operatorit ekonomik – oferta e të cilit në zbatim të formulës të përcaktuar në legjislacion ka

dalë anomalisht e ulët, sqarimet e dhëna nuk janë shoqëruar me dokumentacion provues që të argumentojnë ofertën anomalisht të ulët (në kuptim të: *metodës së përzgjedhur, zgjidhjeve teknike të posaçme, kushte përjashtimisht favorizuese që gëzon ofertuesi apo origjinaliteti i punës së propozuar*), duke mos krijuar bindjen se kjo ofertë është e rregullt në të gjithë elementët e saj me qëllim garantimin e një kontrate të suksesshme.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “BNT Electronics” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr. Ref-59090-03-28-2018, me objekt: “*Blerje pajisje kompjuterike për nevoja të shoqërisë*”, me fond limit 9.199.361 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 30.04.2018, nga autoriteti kontraktor, Ujesjelles-Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1056 Protokolli,

Datë 04.06.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha